



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 189

Tiranë – E hënë, 30 tetor 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 23, datë 16.10.2017	Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 15, datë 19.5.2017, “Për procedurat e pranimit dhe të regjistrimit në vitin akademik 2017- 2018”, të ndryshuar..... 9267
Urdhër i ministrit të Brendshëm nr. 1045, datë 18.10.2017	Për delegim kompetencash..... 9267
Urdhër i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 527, datë 20.10. 2017	Për delegim kompetencash..... 9268
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 341/3, datë 23.10.2017	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Belvedere Vlorë” 9268
Kërkesë e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 10903, datë 24.10.2017	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga “Masterplani 2016–2030 i Universitetit Bujqësor të Tiranës” 9269



UDHËZIM

Nr. 23, datë 16.10.2017

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN
NR. 15, DATË 19.5.2017, “PËR
PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË
REGJISTRIMIT NË VITIN AKADEMIK
2017-2018”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 9, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

1. Në pikën 2, germa “C” e kreut III, të udhëzimit nr. 15, datë 19.5.2017, të ndryshuar, shtohet si më poshtë:

“2. Gjatë periudhës 16 deri 26 tetor, institucionet e arsimit të lartë vijojnë me procedurat e regjistrimit të kandidatëve nëpërmjet portalit U-Albania, në programet e studimit në të cilat kanë aplikuar në raundin e parë apo të dytë. Të drejtën e regjistrimit e kanë kandidatët që nuk rezultojnë të regjistruar në një program tjetër studimi. Institucionet e arsimit të lartë gjatë regjistrimeve respektojnë renditjen e kandidatëve deri në plotësimin e kuotave. Procedurat për regjistrimin e kandidatëve përcaktohen nga njësitë kryesore të IAL-ve.”.

2. Pika 4 e germës “C”, të kreut III të udhëzimit nr. 15, datë 19.5.2017, të ndryshuar, ndryshon si më poshtë:

“4. Në rast se përfundon e gjithë lista e kandidatëve që kanë aplikuar në raundin e dytë dhe mbeten kuota të paplotësuara në programet përkatëse të studimit, njësitë bazë në institucionet e arsimit të lartë përzgjedhin kandidatët fitues sipas kërkesave të depozituara nga kandidatët që nuk rezultojnë të regjistruar në një program tjetër studimi, pavarësisht përzgjedhjeve në raundin e parë apo të dytë. Kandidatët përzgjedhin dhe rankohen nga njësitë bazë dhe miratohen nga drejtuesi i njësisë kryesore, duke njoftuar QSHA-në dhe duke ngarkuar një kopje elektronike të këtyre listave në portalin U-Albania. Sekretaritë mësimore regjistrojnë kandidatët e miratuar nga drejtuesi i njësisë kryesore sipas renditjes deri në plotësimin e kuotave për programet përkatëse të studimit.

Regjistrimi i kandidatit, i cili paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar

prej tij, kryhet pranë sekretarive mësimore nga data 16 deri më datë 26 tetor 2017, nëpërmjet dokumentacionit të përcaktuar në këtë udhëzim.”.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, si dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Lindita Nikolla

URDHËR

Nr. 1045, datë 18.10.2017

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të nenit 56 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor të Ministrisë së Brendshme, znj. Anila Trimi, Sekretar i Përgjithshëm, për të gjitha procedurat e prokurimit publik të kësaj ministrie dhe për kryerjen e procedurave të prokurimit, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 28, datë 14.1.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për ngarkimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme për kryerjen e procedurave për prokurimin publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra e shërbime”, të ndryshuar.

2. Këto kompetenca do të ushtrohen nga data 18.10.2017 deri në shfuqizimin e këtij urdhri.

3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Fatmir Xhafaj
Faqe | 9267

**URDHËR****Nr. 527, datë 20.10.2017****PËR DELEGIM KOMPETENCASH**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 13.9.2017, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, z. Koli Bele, me përjashtim të kompetencave që i janë dhënë ekskluzivisht ministrit, sipas kuadrit ligjor në fuqi.

2. Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë do të mbikëqyrë realizimin e kompetencave të deleguara, si dhe do të revokojë çdo akt që nuk do të jetë në përputhje me fushën e veprimtarisë dhe politikat e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

3. Kompetencat sipas pikës 1 të këtij urdhri do të ushtrohen deri në shfuqizimin e tij.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, z. Koli Bele.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Lindita Nikolla

KËRKESE**Nr. 341/3, datë 23.10.2017****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Belvedere Vlorë”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Vlorë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerësimit të tokës në Republikën e Shqipërisë”, për llogaritjen e vlerësimit të trullit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit është 9,561,931 (nëntë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e nëntëqind e tridhjetë e një) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI
I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Artan Shkreli

**LISTA E PRONARËVE TË PASURIVE PRONË PRIVATE QË SHPRONËSOHEN NGA
PROJEKTI BELVEDERE NË LAGJEN “UJI I FTOHTË”, VLORË**

Nr.	ZK	Nr. i pasurisë	Adresa	Pronari	Sipërfaqe truallit	Çmimi i trullit në lekë/m ²	Vlera e trullit lekë	Sipërfaqe ndërtimi	Çmimi i ndërtimit lekë/m ²	Vlera e ndërtimit lekë	Vlera e trullit	Shënime
Belvedere në lagjen “Uji i Ftohtë”, Vlorë												
1	8602	43/560/3	Vlorë	Aglai Dhima, Gjergji Dhima, Theodhoni Dhima, Zaharulla Dhima, Leonora Hyso dhe Olketa Shuka	877	10903	9,561,931				9,561,931.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë

9,561,931.00 lekë



KËRKESË

Nr. 10903, datë 24.10.2017

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga “Masterplani 2016–2030 i Universitetit Bujqësor të Tiranës”. Subjekti kërkues i këtij objekti është Universiteti Bujqësor i Tiranës. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i

Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, për pronarët sipas listës emërore si më poshtë. Pronarët që kanë emrat në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë), me adresë: Rruga e Durrësit, nr. 23, Tiranë.

ZËVENDËSMINISTRI I ARSIMIT,
SPORTIT DHE RINISË
Ervin Demo

LISTA E PASURIVE PRIVATE
ZËRI KADASTRAL: AKTIVITET PRIVAT, SHTËPI BANIMI ETJ.
QË PREKEN NGA REALIZIMI I “MASTERPLANIT 2016–2030 I ZHVILLIMIT TË UNIVERSITETIT BUJQËSOR TË TIRANËS”

Tabela 1

Nr.	ZK	Nr. i pasurisë	Adresa	Pronari	Sipërfaqe trualli	Sipërfaqe ndërtimi	Çmimi i truallit lekë/m ²	Çmimi i ndërtimit lekë/m ²	Vlera e truallit lekë	Vlera e ndërtimit lekë	Vlera e truallit dhe ndërtësës	Shënime
1	8320	1/174	Kodër Kamzë Tiranë	Hazbi Roshi	46.0	26.0	22,985		1,057,310	1,805,551	2,862,861	Konfirmuar nga ZVRPP-ja: Lokal “Hamburger” - ndërtesa sipas situacionit të ndërtimit
2	8320	1/615-ND	Kodër Kamzë Tiranë	Hektor Kamberaj	277.7	277.7	22,985		0	12,817,419	12,817,419	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Godinë e kombinuar 2-katëshe + 1 kat nëntokësor a) Sip. k. nëntokësor 202.3 m ² banim b) Sip. k. përdhe 277.7 m ² aktivitet c) Sip. k. i parë 174.4 m ² aktivitet Shuma totale 452.1 m ² aktivitet
3	8320	1/481	Kodër Kamzë Tiranë	Viviana Toptani Refik Toptani Ibrahim Toptani Evelina Toptani	2,841.0	259.0	22,985		65,300,385	8,783,952	74,084,337	Konfirmuar nga ZVRPP-ja, vilë + truall (aktivitet)
VLERA TOTALE E SHPRONËSIMIT											89,764,617	

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa: Rr "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel/fax +355 4 24 27 004 Tel +355 4 24 27 006

Çmimi 32 lekë